



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “PROJEKTIM I OBJEKTIT "NDERTIM LINJE UJESJELLES
TRANSMETIMI DHE SHPERNDARJE DHE RRJET KANALIZIMESH NE LAKNAS E VALIAS.”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22114311-5

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,557,330 (Pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tre
qind e tridhjetë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 8 të DST.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 1, 2/c, 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" i ndryshuar: "*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji*".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila parashikon se Autoriteti Kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100%e vlerës së perlogaritur te kontrates.

Kriteri konsiderohet i permbushur nese operatoret ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 (nje) vit te periudhes se kerkuar te viteteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kestet e maturuara të vitit 2025, në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 9 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar neni 4 pika 2/d. Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues

do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Kontraten e bashkimit te operateve te deklaruara ne fazen e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 100 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se shërbimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në

realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **3.a** Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate
- **4.c** Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- **5.b** Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- **5.c** Projektim ujesjelles-kanalizime
- **5.h** Projekte vepra hidroteknike-kulla ekuilibri-porte/pontile.
- **8.a** Rivlime inxhinierike.
- **8.c** Sisteme GIS.
- **8.d** Bazamente gjeodezike
- **8.e** Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- **9.b** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike mbi 5 kate
- **9.c** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte te medha H/C, Porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha
- **9.d** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet
- **9.e** Studime e Projektme hidrogjeologjike

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.** (Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41 pika 4 gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 dhe VKM Nr. 267 date 02.05.2024”

- Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i

kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për çdo kategori si më poshtë:

- **3.a** Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate

Projekti permban objekte civile dhe industrial (stacione pompimi) me murature dhe/skelet beton arme deri ne 5 kate per projektim

- **4.c** Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

Projekti permban stacione pompimi qe kerkon sisteme te furnizimit me energji elektrike dhe linja te furnizimit me energji elektrike

- **5.b** Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi

Projekti permban sistemet e furnizimit me uje te zones se Laknasit si dhe kolektoret e shkarkimit te ujrave te ndotura te mbledhura nga sistemi i KUN

- **5.c** Projektim ujesjelles-kanalizime

I gjithë projekti është sisteme te furnizimit me uje dhe KUN

- **5.h** Projekte vepra hidroteknike-kulla ekuilibri-porte/pontile.

Projekti permban depo uje kulle per shkak te terrenit te rrafshet dhe si rezultat kerkon projekte te depove kulle te ujit

- **8.a** Rivelime inxhinierike.

- **8.c** Sisteme GIS.

- **8.d** Bazamente gjeodezike

- **8.e** Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Projekti kerkon rlevime topografike te sistemeve te ujesjelles – kanalizimeve, sistemet GIS, instalimin e pikave gjeodezike per zbatimin e projektit si dhe pregatitjen e hartave te rrjeteve te zones

- **9.b** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike mbi 5 kate

Projekti permban projektimin e objekteve te ndertesave te stacioneve te pompimit dhe depove kulle me lartesi qe e tejkalone 25 m lartesi

- **9.c** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte te medha H/C, Porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha

Depot kulle qe kerkohet te projektohen jane objekte inxhinierike qe transmetojne ngarkesa te medha ne toke dhe si rrjedhim kerkojne studime dhe vleresime inxhinierike per keto struktura

- **9.d** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet

Pjesa dermuese e zones se projektit shtrihet ne zona te dobeta gjeologjike, zona kenetore, etj. Kjo kerkon trajtim dhe vleresim gjeologjik-inxhinierik per terrene te dobeta.

- **9.e** Studime e Projektime hidrogeologjike

Projekti kerkon studime hidrogeologjike per vleresimin e kapacitetit te ujrave nentokesore per hapjen e puseve te shpimit per sigurimin e ujit te kerkuar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale,

CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 1 (një) Drejtues Projekti Projektues (Ndërtim/Hidroteknik)
- 1 (një) Projektues Ndërtimi Profili Konstruktor
- 1 (një) Projektues Gjeodet/Topograf
- 1 (një) Projektues Elektrik
- 1 (një) Projektues Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Arkitekt Design Urban

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndihmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 2 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet e pikave të licences të kërkuara në pikën 2.3.2.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për stafin si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf - Gjykohet si e nevojshme prezenca e 1 **(një)** Inxhinier Gjeodet për kryerjen e rëlevimin topografik dhe perpunimin matjeve në sisteme koordinative të ndryshme dhe përgatitjen e vizatimeve përkatëse për matjet e realizuara. I nevojshëm sipas kategorive të licences.

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik - Gjykohet si e nevojshme prezenca e 1 **(një)** Inxhinier Hidroteknik për të projektuar dhe perlloritur rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimeve ,gjithashtu dhe veprave hidroteknike të nevojshme në objekt.

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave, për periudhën e 3(tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës e vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 6 (gjashtë) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka

në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas detyrës së projektimit. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin që pritet të jetë i angazhuar në këto procedura.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të kenë në Stafin e Shoqërisë ose te kontraktuar për këto projekt Personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. „Autoriteti Kontraktor mund të kerkoje nga OE prova mbi kapacitetin Teknik dhe professional për të siguruar që ata disponojnë resurset dhe aftësit e nevojshme për të përmbushur kontratën me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit vendos këto kriter sit e domosdoshem për të garantuar që operatori ekonomik disponon ekspertizën e nevojshme për hartimin dhe implementimin e masave mbrojtëse së mjedisit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Pa këto certifikime, nuk mund të sigurohet respektimi i standarteve ligjore dhe teknike.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si më poshtë:

- Certifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme): Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.
- Certifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme): Për sistemin e menaxhimit të Mjedisit.
- Certifikatë ISO 39001-2012 (e vlefshme): Për menaxhimin e sigurisë dhe trafikut rrugor.
- Certifikatë ISO 45001-2018 (e vlefshme): Për sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.
- Certifikatë BS PAS 99-2012 (e vlefshme): Për sistemin e menxhimit të integruar.

(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së shërbimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësisht:

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta
- ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit
- ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë

dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

- Certifikatë BS PAS 99-2012 (e vlefshme): Per sistemin e menxhimit te integruar.Eshte kerkuar me qellim konsulencë teknike për sektorët e meposhtemProjektimi, prodhimi, instalimi, riorganizimi dhe shërbimi i impjanteve dhe makinerive për thyerjen, larjen, seleksionimin e inerteve dhe të impjanteve për prodhimin e betonit, asfaltit, pasurimit të mineraleve dhe makinerive të tyre. Konstruksione të ndryshme metalike si: kapanone të mesme dhe të rënda, ura metalike, etj. Prodhim i makinerive industriale dhe pjesë ndërrimi për to. Riparim, shërbim dhe konsulencë teknike .

2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

- 1 (një) Pajisje GPS
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje si dhe skedën teknike.
- 1(një) Pajisje Total Station
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje si dhe skedën teknike.
- 1(një) Drone per fotografim ajror te zones dhe pregatitjen e hartave te zones
 - Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje si dhe skedën teknike.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: **“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** **d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriterë janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriterë detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t’i realizojë këto punimeve.

Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1

të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhornuar.

Argumentim: Eshte vendosur kjo kerkese bazuar ne njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMI

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor ,**nr.34 datë 11/09/2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"PROJEKTIM I OBJEKTIT "NDERTIM LINJE UJESJELLESIT TRANSMETIMI DHE SHPERNDARJE DHE RRJET KANALIZIMESH NE LAKNAS E VALIAS."**me fond limit prej: 5,557,330 (Pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e tridhjetë) lekë pa tvsh., **lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.
